

## **Thirrje për Konsulent/Organizatë**

### **Termet e Referencës**

### **Analizë mbi mekanizmat e përdorur për identifikimin dhe raportimin e dhunës në shkollë**

**Shtator 2021**

#### **I. Hyrje**

Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si organizatë joqeveritare lokale në shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë edhe më herët, që nga viti 1999, si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës. Që nga fillimi, motoja e organizatës ka qenë “Mendo globalisht, vepro lokalisht”, të cilës organizata i ka qëndruar besnike. Misioni i organizatës është “Zhvillimi i komunitetit të njerëzve, grupeve joformale, organizatave, rrjeteve, institucioneve dhe donatorëve përmes avokimit, shkëmbimit të informacionit dhe ndërgjegjësimit” dhe SiV përmes veprimit të saj dëshmon se është një organizatë që kryen veprime lokale bazuar në praktikat më të mira.

#### **II. Informata të përgjithshme**

Syri i Vizionit (SiV) në partneritet me Save the Children Zyra në Kosovë (SCiK), tash e disa vite janë angazhuar në monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, bazuar në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës. Në kuadër të këtij partneriteti, SiV dhe SCiK kanë zhvilluar projekte për të fuqizuar mekanizmat e parandalimit të dhunës, ndëshkimit trupor dhe raportimit të rasteve të dhunës në shkolla. Përderisa, në kuadër të programit të mbrojtjes së fëmijës “Detyrimi ynë për të Ardhmen - Mbrojtja e Fëmijës dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijës”, organizata është duke u punuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve të cilat për mandat kanë mbrojtjen e fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve sa më profesionale dhe me kohë.

#### **IV. Kualifikimi i nevojshëm:**

- Diplomë universitare në psikologji ose në fushën e të drejtave të fëmijëve (kualifikimi master dhe edukimi profesional/joformal është përparësi);

- Dokumentimi i përvojës së punës në hartimin e hartimin e raporteve analitike nga hulumtimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna apo të drejtat e tyre:
- Njohuri për parimet e të drejtave të fëmijëve të bazuara në KDF dhe KB dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës;
- Njohuri mbi sistemin e arsimit në Kosovë, me theks të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre në shkollë;
- Shkathtësi të shkëlqyera analitike, udhëheqëse dhe shkathtësi në shkrim e komunikim;
- Shkathtësi të mira në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe dhe angleze.

## **V. Objektivi**

Syri i Vizionit kërkon të angazhojë një konsulent/e apo organizatë në fushën e hulumtimit dhe analizës në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Qëllimi i këtij hulumtimi/analize është që të dokumentojë një pasqyrim sa më real mbi gjendjen e tanishme në shkollat ku SiV është duke punuar, rreth mekanizmave apo instrumenteve më miqësore ekzistuese në shkollë ku fëmijët adresojnë rastet e dhunës brenda dhe jashtë shkollës dhe çfarë mjetesh/mekanismash ata do të dëshironin të kenë shtesë në shkollat e tyre që të ndihen rehat dhe të sigurt për të raportuar dhunën. Analiza do të zhvillohet në pesë (5) komuna brenda Kosovës (Pejë, Gjakovë, Prizren, Klinë dhe Gjilan). Grupet që do të konsultohen si pjesë e hulumtimit do të jenë fëmijët, prindërit, mësimdhënësit si dhe drejtues të shkollave e institucioneve lokale të cilat për mandat kanë mbrojtjen e fëmijëve (shkollat dhe institucionet relevante do të përcaktohen nga SiV).

## **VI. Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Shqyrtimi i raporteve dhe artikujve ekzistues lidhur me legjislacionin në fuqi.
- Vlerësimi i dokumenteve dhe mekanizmave ekzistuese në shkollat dhe komunat e përzgjedhura si dhe dokumenteve dhe mekanizmave ekzistuese në nivelin qendror.
- Ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes në dispozicion për fëmijët, kujdestarët dhe/ose familjet e tyre, etj.
- Intervista të thella me përfaqësuesit e institucioneve që për mandat kanë mbrojtjen e fëmijëve.
- Intervista dhe bashkëbisedime në grup me përfaqësues të prindërve dhe mësimdhënësve.
- Intervista dhe bashkëbisedim në grup me fëmijët.

- Përpilimi i raportit dhe prezantimi në Power Point i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.
- Përpilimi i raportit dhe prezantimi duhet të bëhet në gjuhën shqipe.
- Vendosja e të gjitha referencave në tekst.

**Realizojë hulumtimin mbi instrumentet/mekanizmat e përdorur për identifikimin dhe raportimin e dhunës në shkolla nga fëmijët.** Hulumtimi do të bëhet në pesë komuna (Pejë, Gjakovë, Prizren, Klinë dhe Gjilan).

#### **VII. Afati kohor:**

Raporti duhet të dorëzohet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga nënshkrimi i marrëveshjes.

#### **VIII. Rezultatet:**

Raporti duhet të përmbajë:

- Përmbledhja ekzekutive (1-2 faqe)
- Objektivi i analizës (1 faqe)
- Kapitulli I - Metodologjia (1 faqe)
- Kapitulli II - Rishikimi i legjislacionit
- Kapitulli III - Ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes në dispozicion për fëmijët/familjet në komunat e caktuara
- Kapitulli IV - Rezultatet nga mbledhja e të dhënave
- Kapitulli V - Rekomandimet
- Kapitulli VI - Implikimet
- Kapitulli VII - Referencat

Konsulenti/ja apo Organizata duhet të punojë për së afërmi me organizatën Syri i Vizionit dhe Save the Children gjatë përpilimit të dokument analizës të paraparë me këto Terma të Referencës.

Rekomandimet e kësaj analize studimore duhet jenë të qarta dhe reale me situatën në shkollë e komunë, se si shkolla duhet të krijojë instrumente/mekanizma miqësorë për fëmijë për të adresuar dhunën si dhe rekomandime se çfarë mund të bëjnë prindërit dhe institucionet tjera përgjegjëse për parandalimin e dhunës nëpër shkolla.

### **IX. Kërkesat për aplikim**

Kandidatët e interesuar ftohen që të aplikojnë duke i dërguar dokumentet e mëposhtme:

- I. Kopjen e diplomës universitare (ndonjë çertifikatë e licencimit nga institucione relevante vlerësohet si përparësi);
- II. Përshkrimin e metodologjisë së punës, duke përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të hulumtimit të specifikuar sipas komunave;
- III. Një plan tentativ të punës;
- IV. Një letër motivuese ku përfshihet përvoja, gatishmëria dhe aftësitë profesionale në hartimin e raporteve apo analizave të tilla (bashkangjit ndonjë kopje të raportit) që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve apo të ngjashme;
- V. Biografinë (CV)
- VI. Propozimin financiar\*

\*Kërkesa financiare duhet të jetë bruto, e detajizuar për secilën punë që do të realizohet, duke përfshirë: burimin e informatave, procedurat dhe teknikat e mbledhjes së informatave, teknikat e analizës së të dhënave, planin tentativ të punës si dhe shkrimin e raportit.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në gjuhën lokale, në formë elektronike në adresën:

[office@syriivizionit.org](mailto:office@syriivizionit.org) ose [info@syriivizionit.org](mailto:info@syriivizionit.org) me titullin: **Analizë mbi mekanizmat e përdorur për identifikimin dhe raportimin e dhunës në shkollë**, apo edhe përmes postës fizike në adresën e organizatës - OJQ: “Syri i Vizionit”, Rr. Isa Demaj, nr. 14, 30000 Pejë, Kosovë. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është: **04 tetor 2021, ora 16:00**.

***Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!***